

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 21

ASSIST sh.p.k
 Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
 më 31 dhjetor 2018

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	14,111,454	11,800,140
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	286,109,876	224,872,827
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	30,029,512	26,253,636
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	89,107,429	59,597,555
Shpenzime të shtyra	8	173,471	-
Aktive tatimore të shtyra	26	914,833	1,953,102
Total aktive afatshkurtra		420,446,575	324,477,260
Aktive afatgjata			
Shpenzime të shtyra	9	199,627,955	180,835,696
Aktive afatgjata materiale	10	58,324,080	52,009,332
Aktive afatgjata jomateriale	11	130,133	153,098
Total aktive afatgjata		258,082,168	232,998,126
Total aktive		678,528,743	557,475,386
DETYRIME			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	12	27,493,427	31,304,150
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	27,467,574	17,955,053
Detyrime tatimore	14	34,491,678	31,133,604
Të tjera detyrime	15	73,911,597	53,476,512
Total detyrime afatshkurtra		163,364,276	133,869,319
Detyrime afatgjata			
Hua nga palët e lidhura	16	304,847,400	328,386,500
Total detyrime afatgjata		304,847,400	328,386,500
Total detyrime		468,211,676	462,255,819
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	17	1,400,000	1,400,000
Rezerva ligjore		140,000	52,060
Rezerva të tjera		93,679,567	816,284
Fitimi i ushtrimit		115,097,500	92,951,223
Total kapitali		210,317,067	95,219,567
Total kapitali dhe detyrime		678,528,743	557,475,386

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	1,220,802,105	664,482,653
Të ardhura/(shpenzime) të tjera të shfrytëzimit, neto	19	(19,550,513)	(2,666,010)
Shpenzime administrative dhe të tjera		(173,217,828)	(110,702,167)
1) Shpenzime administrative	20	(121,746,989)	(91,505,537)
2) Të tjera shpenzime	21	(51,470,839)	(19,196,630)
Shpenzime të personelit	22	(900,197,266)	(433,808,952)
1) Paga dhe shpërblime		(776,601,149)	(375,806,741)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pension)		(123,596,117)	(58,002,211)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10/11	(13,948,262)	(11,207,582)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	23	(31,920)	(16,655)
Të ardhura të tjera		-	-
Të ardhura / (shpenzime) financiare neto	24	22,442,331	3,601,262
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njesitë ekonomike brenda grupit)		(1,104,609)	(1,154,338)
2) Të ardhura të tjera financiare		23,546,940	4,755,600
Fitimi para tatimit		136,298,647	109,682,549
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	25	(21,201,147)	(16,731,326)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(20,162,878)	(18,684,428)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		(1,038,269)	1,953,102
Fitimi i vitit		115,097,500	92,951,223
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		115,097,500	92,951,223

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ASSIST sh.p.k
 Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lek)


Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
 për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitimi ushtrimit	Total
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	1,400,000	-	(172,846)	1,041,190	2,268,344
Fitimi i vitit	-	-	-	92,951,223	92,951,223
Lëvizjet përmes kapitalit	-	52,060	989,130	(1,041,190)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	1,400,000	52,060	816,284	92,951,223	95,219,567
Fitimi i vitit	-	-	-	115,097,500	115,097,500
Lëvizjet përmes kapitalit	-	87,940	92,863,283	(92,951,223)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	1,400,000	140,000	93,679,567	115,097,500	210,317,067

Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori Franco Fradiani dhe janë firmosur më 29 Mars 2019 si më poshtë:


 Z. Franco FRADIANI
 Administrator




 Mazars shpk

Hartues i Pasqyrave Financiare

 MAZARS

Rr. Emin Duraku, Palli "Binjaket",
 No.5, 1000, Tirana, Albania
 phone : +355 42 27 80 15
 www.mazars.al , info@mazars.al

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënime të shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim i vitit pas tatimit	115,097,500	92,951,223
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	(19,154,968)	(2,853,819)
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	7,105,782	12,217,234
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	13,948,261	11,207,582
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rritje në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(94,522,799)	(234,359,406)
Rritje/(rënie) në inventarë	-	500,000
Rënie në detyrimet e pagueshme	(397,309,438)	(258,819,479)
Rritje në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(18,965,730)	(53,413,955)
Rritje në detyrime për punonjësit	420,736,882	355,786,957
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	26,935,490	(76,783,663)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(20,240,044)	(24,501,247)
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata jo materiale	-	(171,608)
Mjete monetare neto përdorur në aktivitetin e investimit	(20,240,044)	(24,672,855)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	-	112,717,200
Mjete monetare neto gjeneruar nga aktiviteti i financimi	-	112,717,200
Rënie neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	6,695,446	11,260,682
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	11,800,140	2,441,239
<i>Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(4,384,132)	(1,901,781)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	14,111,454	11,800,140

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

“Assist shpk” është rregjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë rregjistrave të Qendrës Kombëtare të Rregjistrimeve më datë 17 nëntor 2015 me NIPT L52317008R.

Selia e shoqërisë është: Rruga “Emin Duraku”, Pall “Binjakët”, Nr.5, Tiranë, Shqipëri.

Kapitali i shoqërisë është 1,400,000 lekë i ndarë në 1 kuotë. Administratori i shoqërisë është z. Franco Fradiani.

Ortaku i vetëm i shoqërisë është shoqëria e huaj “Assist s.p.a” e cila zotëron 100% të kapitalit.

Aktiviteti i shoqërisë është studimi, konsulenca, projektimi, realizimi dhe shërbimet e manaxhimit të kompanive, për ndërmarrjet dhe entet drejtuese për të mbështetur shitjen e mallrave apo kryerjen e shërbimeve të vetë klientëve.

Më 31 dhjetor 2018 shoqëria kishte 937 punonjës, (2017: 604 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe amenduar me urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre duke filluar nga 1 janar 2015

Ky urdhër hyri në fuqi në fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

Kompania përdor formatin e publikuar nga NAS për prezantimin e pasqyrave financiare.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)****2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2018	2017
Euro/LEK	123.42	132.95
USD/ LEK	107.82	111.10

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

<u>Kategoria e aktiveve</u>	<u>Metoda e Amortizimit</u>	<u>Norma e Amortizimit</u>
Mobije dhe orendi	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje kompjuterike	Vlera e mbetur	25 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20 %

iii. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017:15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundur që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Mjete monetare në bankë	14,078,260	11,768,370
Mjete monetare në arkë	33,194	31,770
	<u>14,111,454</u>	<u>11,800,140</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Klientë	284,838,752	224,872,827
Klientë për fatura të pa aprovuara	1,271,124	-
	<u>286,109,876</u>	<u>224,872,827</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të arkëtueshme tregtare nga Assist SPA	11,275,843	5,809,117
Të arkëtueshme tregtare nga Assist BEEWEEB	14,001,073	18,126,403
Të arkëtueshme tregtare nga Assist Digital S.A.S	4,752,596	-
Të arkëtueshme tregtare për fatura të pa aprovuara nga Assist BEEWEEB	-	2,318,116
	<u>30,029,512</u>	<u>26,253,636</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
TVSH	88,811,876	59,585,390
Fond garanci	128,110	-
Detyrime doganore	8,689	12,165
Të arkëtueshme nga punonjësit	158,754	-
	<u>89,107,429</u>	<u>59,597,555</u>

8. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Parapagime Infosoft Office	91,526	-
Të tjera shpenzime të periudhave të ardhshme	81,945	-
	<u>173,471</u>	<u>-</u>

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime të periudhave të ardhme për përshtatje ambjentesh punuese	191,693,716	172,681,796
Parapagime garanci qiraje	7,934,239	7,934,239
Të tjera shpenzime të periudhave të ardhshme	-	219,661
	<u>199,627,955</u>	<u>180,835,696</u>

10. Aktive afatgjata materiale

	Automjetet	Mobilje orendi	Pajisje kompjuterike	Të tjera	Totali
Kosto					
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	25,289,048	14,624,904	409,080	40,323,032
Shtesa	1,403,430	5,487,508	15,044,093	2,566,216	24,501,247
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,403,430	30,776,556	29,668,997	2,975,296	64,824,279
Shtesa	-	11,809,597	6,203,021	2,227,426	20,240,044
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,403,430	42,586,153	35,872,018	5,202,722	85,064,323
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	1,091,328	514,093	20,454	1,625,875
Amortizimi i vitit	-	5,414,608	5,293,962	480,502	11,189,072
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	6,505,936	5,808,055	500,956	12,814,947
Amortizimi i vitit	280,686	6,254,154	6,636,064	754,392	13,925,296
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	280,686	12,760,090	12,444,119	1,255,348	26,740,243
Vlera neto kontabël					
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	24,197,720	14,110,811	388,626	38,697,157
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,403,430	24,270,620	23,860,942	2,474,340	52,009,332
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,122,744	29,826,063	23,427,899	3,947,374	58,324,080

11. Aktive afatgjata jomateriale

	<u>Liçenca Windows</u>	<u>Totali</u>
Kosto		
Gjendja më 31 dhjetor 2016		
Shtesa	171,608	171,608
Nxjerrje jashtë përdorimit		
Gjendja më 31 dhjetor 2017	171,608	171,608
Shtesa	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit		
Gjendja më 31 dhjetor 2018	171,608	171,608
Amortizimi i akumuluar		
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	-
Amortizimi i vitit	18,510	18,510
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	18,510	18,510
Amortizimi i vitit	22,965	22,965
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	41,475	41,475
Vlera neto kontabël		
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	153,098	153,098
Gjendja më 31 dhjetor 2018	130,133	130,133

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Furnitorë vendas	18,778,260	25,381,554
Furnitorë të huaj	7,179,256	5,422,174
Furnitorë vendas për fatura të pambërritura	1,535,911	500,422
	27,493,427	31,304,150

13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të pagueshme tregtare Assist S.p.a.	23,469,518	13,648,283
Të pagueshme tregtare Assist Doo	3,998,056	4,306,770
	27,467,574	17,955,053

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	20,395,707	12,801,867
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	7,951,311	4,107,224
Tatimi në burim	77,147	54,177
Tatimi fitimi	6,067,513	14,170,336
	<u>34,491,678</u>	<u>31,133,604</u>

15. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Pagat e punonjësve	66,238,271	39,586,717
Detyrime për pushime të përlogaritura	6,098,886	6,420,680
Detyrime për bonuse të përlogaritura	-	6,600,000
Të tjera	1,574,440	869,115
	<u>73,911,597</u>	<u>53,476,512</u>

16. Hua nga palët e lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Finacim Assist S.p.a.	304,847,400	328,386,500
	<u>304,847,400</u>	<u>328,386,500</u>

17. Kapitali

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 1400,000 Lekë i ndarë në 1 kuotë, i zotëruar 100% nga shoqëria italiane "Assist spa".

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shërbim Call Center	1,219,530,981	662,147,973
Shërbim Call Center të përlogaritura	1,271,124	2,334,680
	<u>1,220,802,105</u>	<u>664,482,653</u>

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruara në FDP-në e TVSH-së	1,220,802,105
Shitje të deklaruara në FDP-në që janë të ardhura në PASH	1,220,802,105
Shërbime	1,220,802,105
Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	1,220,802,105
Fitim nga këbimet valutore	28,116,464
Total të ardhura të deklaruara në FDP-në e Tatim Ftimit	1,248,918,569

19. Të ardhura / (shpenzime) të tjera të shfrytëzimit neto

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/(humbjet) që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Humbje nga këmbimet valutore	(24,127,876)	(4,277,046)
Fitim nga këmbimet valutore	4,577,363	1,611,036
	(19,550,513)	(2,666,010)

20. Shpenzime administrative

Në këtë zë paraqiten shpenzimet administrative që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Shpenzimet administrative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime amortizimi për pershtatje të ambjenteve	45,307,470	36,217,894
Qira Zyra	34,811,861	23,480,244
Shërbim interneti	10,539,642	1,863,976
Shërbime teknike	10,046,740	16,473,282
Energji elektrike	8,687,320	5,299,087
Konsulenca	4,864,373	-
Pajisje ndihmëse	3,077,589	3,144,185
Shërbim konsulte për rekrutim stafi	2,651,407	4,495,469
Shpenzime trajnimi	1,550,048	183,000
Shpenzime telekomunikacioni	210,539	348,400
	121,746,989	91,505,537

21. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shërbim pastrimi	11,328,360	-
Shpenzime transport	6,859,605	3,544,906
Konsulencë ekonomike	5,874,881	3,793,464
Shërbim ruajtje	5,226,954	-
Dieta	3,672,523	352,982
Shpenzime pritje	2,951,107	2,867,712
Liënsa softwer	2,210,814	974,157
Utilitete	2,196,225	946,275
Shpenzime mirëmbajtje	2,121,421	724,367
Të tjera	1,948,615	1,235,265
Shpenzime postare the telefonie	1,497,832	940,339
Dhurata	1,182,528	113,600
Shërbim auditimi	933,150	-
Kousulencë juridike	774,435	805,470
Shpenzime bankare	633,535	599,405
Shpenzime parkimi	490,080	245,400
Shpenzime publicitare	480,759	737,131
Taksa vendore	377,000	134,000
Prime sigurimi	302,371	110,017
Qira Pajisje	212,520	159,332
Kancelari	196,124	238,222
Qira hapsire publicitare	-	674,586
	<u>51,470,839</u>	<u>19,196,630</u>

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime për paga	783,522,943	362,786,061
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	123,596,117	58,002,211
Shpenzime per shperblime te perllogaritura	-	6,600,000
Rimarrje shpenzime për shperblime të perllogaritura	(6,600,000)	-
Shpenzime për pushime të perllogaritura	2,866,481	6,420,680
Rimarrje shpenzime për pushime të perllogaritura	(3,188,275)	-
	<u>900,197,266</u>	<u>433,808,952</u>

23. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Gjoha dhe penalitete	31,920	16,655
	<u>31,920</u>	<u>16,655</u>

24. Shpenzime / të ardhura financiare neto

Të ardhura / (shpenzime) financiare përfshijnë shpenzimet / të ardhurat e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime për interesa	(1,104,609)	(1,154,338)
Fitim nga këmbimet valutore	7,840	-
Të ardhura nga këmbimet valutore	23,539,100	4,755,600
	<u>22,442,331</u>	<u>3,601,262</u>

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	136,298,647	109,682,549
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	(1,879,461)	14,880,306
Shpenzime pritje dhe përcjellje	52,310	874,265
Shpenzime udhëtimi	14,463	-
Penalitet, gjoha e dëmshpërblime	31,920	16,655
Dhurata	1,182,528	113,600
Shpenzime interesash të panjohura	-	70,795
Bonuse dhe pushime të përlllogaritura	2,866,481	13,020,680
Rimarrje përlllogaritje të pushimeve dhe bonuse	(9,788,275)	-
Shpenzime pa faturë të rregullt tatimore	3,761,112	784,312
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	134,419,186	124,562,855
Tatim fitimi 15%	20,162,878	18,684,428
Të ardhura / shpenzime nga tatimi i shtyrë	1,038,269	(1,953,102)
Fitim / (humbja) e vitit	115,097,500	92,951,223

26. Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	Paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar	
	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Tatim fitimi i shtyrë llogariur për pushimet dhe bonuset e punonjësve të pa dhëna	914,833	1,953,102
Tatim i shtyrë i ardhur	914,833	1,953,102
	Paraqitur në Pasqyrën e Performancës	
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Tatim fitimi i shtyrë llogariur për pushimet dhe bonuset e punonjësve të pa dhëna	(1,038,269)	1,953,102
Tatim i shtyrë aktiv / (detyrim)	(1,038,269)	1,953,102

Rakordimi i tatimit të shtyrë paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Balanca me 01 janar		
Tatimi i shtyrë ardhur (shpenzim) gjatë vitit	(1,038,269)	1,953,102
Balanca më 31 dhjetor	(1,038,269)	1,953,102
Tatim fitimi i shtyrë		
Përllogaritje pushime dhe bonuse 2018	6,098,886	13,020,680
Pushime të dhëna në 2018	(6,420,680)	-
Bonuse të dhëna	(6,600,000)	-
Total	(6,921,794)	13,020,680
Tatim fitimi i shtyrë 15%	(1,038,269)	1,953,102

ASSIST sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

27. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

Bilanci kontabël	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Assist spa	328,316,918	342,034,783
Assist Doo	3,998,056	4,306,770
	332,314,974	346,341,553
	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të arkëtueshme nga palët e lidhura		
Assist SPA	11,275,843	5,809,117
Assist BEEWEEB	14,001,073	18,126,403
Assist Digital S.A.S	4,752,596	-
Të ardhura të përlogaritura nga Assist BEEWEEB	-	2,318,116
	30,029,512	26,253,636

Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Blerje nga palët e lidhura		
Assist spa	11,164,671	13,297,727
Assist DOO	-	4,329,892
	11,164,671	17,627,619
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shitje për palët e lidhura		
Assist spa	68,244,348	93,975,048
Assist BEEWEEB	31,045,459	18,228,862
Assist Digital S.A.S	4,784,054	-
Të ardhura të përlogaritura nga Assist BEEWEEB	-	2,318,116
	104,073,861	114,522,026

28. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2018, Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

29. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

